



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Data: 17 Janar 2017

NJOFTIM

Nga qendra e thirjeve që u dedikohet të sëmurave kronik janë kontaktuar

68.502 pacientë

Në lidhje me zbatimin e projektit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë 'Fondi kujdeset për personat me sëmundje kronike' Ju informojë me rezultatet më të reja nga qendra e thirjeve telefonike që u dedikohet të sëmurave kronik, nga ana e të punësuarve të Fondit. Deri më tani janë kontaktuar gjithsej 68.502 të siguruar të prekur nga sëmundja e diabetit, sëmundja kardiovaskulare dhe sëmundja e veshkëve. Ky projekt rrjedh sipas dinamikës së planifikuar.

Nga përvoja e 10 timeve të formuara në kuadër të Fondit, me kënaqësi Ju njoftojmë se kontakti i zhvilluar nga 1 Tetori 2015 e deri më sot, ka reflektuar pozitivisht tek të siguarit.

Sipas telefonatave të deritanishme është konstatuar se shumica e të siguarve janë të njohur me peshën e sëmundjes që janë prekur, kanë informata themelore për terapinë që duhet t'a pranojnë, për mënyrën e të ushqyerit dhe për stilin e jetesës. Por, nuk janë evituar rastet e atilla kur të siguarit kanë qenë të vetëdijshëm për sëmundjen që janë prekur, por nuk kanë qenë të informuar mire për pasojat që mund të hasin në qoftë se nuk e aplikojnë terapinë e duhur në kohë. Megjithatë, pas shpjegimeve konkrete nga ana e të punësuarve të Fondit, të siguarit kanë shprehur gadishmërinë e tyre për përgjegjësinë ndaj rekomandimeve të mjekut dhe ndaj shëndetit të tyre.

Gjatë këtyre thirjeve të siguarit e kanë shfrytëzuar mundësinë për t'u interesuar edhe për të drejtat tjera saS i përket sigurimit shëndetësor gjegjësisht, për realizimin e të drejtës për paisjet ortopedike, për rehabilitimin mjekësor si mjekim i vazhduar spitalor, dhe informata shtesë rreth barnave që janë në listën pozitive.

Timet e formuara me të punësuarit e Fondit u përkasin njësitë më të mëdhaja rajonale siç janë Shkupit, Tetovës, Shtipit, Manastirit, Strumicës, Velesit, Prilepit dhe Kumanovës.